



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr. 40 ,datë 16.1.2008

PER
DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 191. DATE 22.3.2007, TE KESHILLIT
TE MINISTRAVE, “PER VENDOSJEN E Oponences Teknike
SHTETERORE PER PROJEKTET E NDERTIMIT TE
HIDROCENTRALEVE ME KONCESION”

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, date 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9367, date 7.4.2005, “Per parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të neneve 4, 6, 8 e 18, të ligjit nr. 8402, date 10.9.1998, “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, dhe të ligjit nr.9836, date 26.11.2007, “Per buxhetin e shtetit, të vitit 2008”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ne vendimin nr.191, date 22.3 .2007, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si me poshte vijon:

“2. Oponenca teknike shtetërore per projektet e parashikuara sipas pikes 1, të këtij vendimi, të bëhet nga një grup ekspertësh të shquar në fushën e inxhinierisë hidroteknike, hidrologjike, gjeologjike dhe të mjedisit. Ky grup nuk do të ketë me shumë se 18 eksperte dhe emërimi i tyre bëhet me urdhër të ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Menyra e funksionimit të grupit percaktohet me udhëzim te ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”.

2. Pikat 3 e 4 permbliidhen në nje pike të vetme, me numrin 3, me këtë permbajtje:

“3. Grupi i eksperteve ben vlerësimin tekniko-mjedisor të projekteve, duke synuar shfrytëzimin optimal të burimeve ujore. Grupi i ekspertëve, me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, kryen oponencen per çdo projektpropozim dhe, pas perfundimit të oponencës, harton raportin përkatës të vlerësimit tekniko-mjedisor të tij. Materiali i oponencës dërgohet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes per vazhdimin e procedurave. Gjithashtu, me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, grupi i ekspertëve kryen studime në fushën hidroenergjetike”.

3. Pikat 5 e 6 numërtohen, perkatesisht, 4 e 5.

4. Pika 7 numërtohet pika 6 dhe ndryshohet, si me poshte vijon:

“6. Pagesa e grupit të ekspertëve per periudhen 1 janar deri në 1 korrik 2008, të perballohet nga fondet operative, të miratuara në buxhetin e vitit 2008, per Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, në shumën 10 758 000 (dhjetë milionë e shtatëqind e pesedhete e tetë mijë) lekë”.

5. Pika 8 shfuqizohet dhe pika 9 e vendimit numërtohet 8.

6. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës per zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

